

REPUBLICA E SHQIPERISE  
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE  
NR 28409 REGJ.

28409

**V E N D I M**  
**MBI REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK**

Ne Tirane, sot me daten 17.10.2002, une Amila Cepo  
gjqtare ne Gjykatën e Shkalles se pare Tirane, pasi pashe kerkesen dhe materiale t e  
kerkuesit ARJAN PRODANI ben fjale per regjistrimin si person juridik te shoqerise  
me Pergjegjesi te Kufizuar ne emrin " SOT +" SHPK,

**K O N S T A T O V A :**

Se kerkuesi ARJAN PRODANI ka bere kerkesë per te bere regjistrimin si  
person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emrin " SOT +" SHPK, per  
te ushtruar veprimtari private ne fushen e : **Ushtrimin e aktivitetit ne fushen e**  
**grumbullimit dhe botimit te informacionit me karakter ekonomik e**  
**shoqeror, botim gazetash, librash e revistash, broshurash, fletëpaqlosjesh, posterash**  
**e materiale te tjera me karakter publicistik e jo publicistik, tipografi, import-**  
**eksport letre, paisje e materiale tipografike, si dhe botimin e Gaztes "Sot", import-**  
**eksport mallrash industriale, ushqimore fruta e perime, pije alkoolike dhe jo alkoolike,**  
**materiale ndertimi, elektroshtepiake, karburante, vajra lubrifikante me pakice, dhe**  
**perpunimin te produkteve ushqimore.**

Kapitali themelor i shoqerise do te jete ne shume **100.000 leke.**

Selia e saj do te jete ne **Rr."Pjeter Bogdani 9/1 TIRANE.**

Administrator i saj do te jete **Z. ARJAN PRODANI.**

Kohezgjatja e shoqerise do te jete mbi 15 vjet.

Ortaket e shoqerise do te jene :

- 1)Z.ARJAN PRODANI
- 2)Z.SHPETIM PRODANI
- 3)Z.ARBEN MECE
- 4)Z.SOKOL KOSOVA
- 5)Z.MARTIN LEKA

Nga shqyrtimi i materialeve rezulton se kerkesa eshte e bazuar ne ligj dhe si e tille  
duhet pranuar,

**PER KETO ARSYE:**

Ne baze te ligjit 7638 date 19.11.1992 dhe te ligjit 7667 date 28.01.1993,

**V E N D O S A :**

Regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emrin  
"SOT +" SHPK, me ortake:

- 1)Z.ARJAN PRODANI
- 2)Z.SHPETIM PRODANI
- 3)Z.ARBEN MECE
- 4)Z.SOKOL KOSOVA
- 5)Z.MARTIN LEKA †


per te ushtruar veprimtarine private ne fushen e : Ushtrimin e aktivitetit ne fushen e grumbullimit dhe botimit te informacionit me karakter ekonomik e shoqeror, botim gazetash, librash e revistash, broshurash, fletepalosjesh, posterash e materiale te tjera me karakter publicistik e jo publicistik, tipografi, import-eksport letre,paisje e materiale tipografike, si dhe botimin e Gaztes "Sot", import-eksport mallrash industriale,ushqimore fruta e perime,pije alkoolike dhe jo alkoolike, materiale ndertimi,elektroshtepiake, karburante,vajra lubrifilkante me pakice,dhe perpunimin te produkteve ushqimore.

Kapitali themelor I shoqerise do te jete 100.000 leke.  
Selia e shoqerise do te jete ne Rr."Pjeter Bogdani (TIRANE).  
Kohezgjatja mbi 15 vjet .  
Administrator i shoqerise do te jete Z.ARJAN PRODANI.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim .

Tirane, 17.10.2002

**GJYQTARE**



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA E SHKALLES SE PARE**  
**TIRANE**

Nr 28409/1

**VENDIM**

Ne Tirane sot me daten 30.09.2003 une gjyqtaria e Gjykeses se Shkalles se Pare Tirane f. 307 pasi shqyrtova kerkesen e kerkuesit : Arjan Prodani , biri Muhametit dhe i Manushaqes , dtl 25.09.1965 , banues ne Tirane

**KONSTATOVA**

Me vendim nr 1 date 26.08.2003 te Asamblese se ortakeve te Shoqerise "SOT+"SHPK , e cila eshte e regjistruar si person juridik eshte vendosur : Miratimin e shitjes se kuotave te ortakut Shpetim Prodani 26% , Arben Meçe 10% , Sokol Kosova 20% tek ortakut Arjan Prodani duke u bere zoterues ortakut Arjan Prodan i 91% te kuotave te kesaj shoqerise Me kontraten e shitjes se kuotave Nr 3779 rep , Nr 200 kol dt 18.09.2003 eshte bere shitja e kuotave qe zoteronin nga ortaket Shpetim Prodani , Arben Meçe dhe Sokol Kosova tek ortakut Arjan Prodani. Ne keto kushte ky vendim i Asamblese dhe kontrata e shitjes se kuotave duhet te pasqyrohen ne regjistrin tregetar . Kerkesa e kerkuesit eshte e drejt dhe duhet pranuar

**P.K.A**


Ne baze te Ligjit nr 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregetare " dhe Ligjit Nr 7667 , date 28.1.1993 " Per regjistrin tregetar "

**VENDOSI**

Pranimin e kerkeses

Depozitimine vendimit nr 1 date 26.08.2003 te Asamblese se ortakeve te shoqerise "SOT+"SHPK per shitjen e kuotave Shpetim Prodani , Arben Meçe dhe Sokol Kosova tek ortakut Arjan Prodani Depozitimi i kontrates se shitjes se kuotave Nr 3779 rep , Nr 200 kol dt 18.09.2003 nga ortaket Shpetim Prodani , Arben Meçe dhe Sokol Kosova tek ortakut Arjan Prodani Pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne regjistrin tregetar

**GJYQTARI**



URDHËR REGJISTRIMI

Kolona I	Numri i Regjistrimit Tregtar: <u>08409</u>
Kolona II	A. Emri i Shoqërisë: <u>Lot + "L.P.K"</u> B. Selia: <u>2 Zetë Bopoldina C/1</u> C. Objekti: <u>Udhëtimi e aktivitetit</u> <u>me funksionet e punësullës</u> <u>duke të ndihmë</u> D. Kapitali: <u>100.000.000.000</u>
Kolona III	A. Ortakët: <u>Arjan Kodou</u> <u>Shyqir Kodou, Arben Kucë</u> <u>Solvet Tuzova, Martin Selue</u> B. Administratorët: <u>Arjan Kodou</u>
Kolona IV	Kohëzgjatja: <u>15 vjet</u>
Kolona V	Shënime mbi aktet e shoqërisë: A. Data e Nënshkrimit: <u>16.10.2002.</u> B. Data e regjistrimit: <u>17.10.2002.</u> C. Statuti fletë: <u>6 fletë</u> D. Akti i Themelimit fletë: <u>9 fletë</u>

Shënime: vertetur sipas aktit nr 13 rep lloje  
lloje aktit sipas kësaj

GJYQTARE  
Mirza Cof



## KONTRATE PER THEMELIMIN E SHOQERISE “ SOT +” Shpk”

E lidhur ndermjet paleve:

1) ARJAN PRODANI, i biri i Muhametit dhe i Manushaqes, i dtl. 25.09. 1965, banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar., me pasaporte me nr 1995375.

2) Z.SHPETIM PRODANI i biri i Muhametit dhe i Sherihatit, i dtl. 02.11. 1950, me banim ne Durres, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, me pasaporte me nr-14121696

3) Z.ARBEN MECE, i biri i Laverit, dhe i Nazimes, idtl. 01.12.1961, me banim ne Fier, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar me pasaporte me nr 1321135.

4) Z.SOKOL KOSOVA i biri i Bardhytit dhe i Rukijes, i dtl 17.12.1957, me banim ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar me leternjoftimin me nr AZ 052860

5) MARTIN LEKA, i biri i Bardhokut dhe i Diles, i dtl. 08.07. 1959, me banim ne Kukes, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar me pasaporte me nr 0011472.

Palet duke qene te pranishem, te deklaruar ortake rane dakort qe kontraten e themelimit te shoqerise e se perbashket ta formulojne sipas kerkesave te ligjit 7638 date 19.11.1992 “Per shoqerite Tregtare “ si dhe ne baze te ligjit 7667 date 28.1.1993. “ Per regjistrin Tregtar”, vendosen sa me poshte:

### NENI 1

Te krijohje shoqerine me Pergjegjesi te Kufizua “ SOT +” SHPK, e cila do te veproje ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, dispozitat e kesaj kontrate, me statutin e perbashket dhe ligjin 7871, date 09/11/1994,

### NENI 2

Shoqeria “ SOT + ” Shpk do te kete seline Rr.”Pjeter Pogdani” 9/1 TIRANE dhe do te ushtroje veprimtari per nje periudhe kohe mbi 15 vjet, me te drejte perseritjeje per periudhen e metejshme neqoftese bien dakort ortaket unanimisht, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

### NENI 3

Shoqeria “ SOT +” Shpk do te kete per objekt te veprimtarise se saj :

Ushtrimin e aktivitetit ne fushen e grumbullimit dhe botimit te informacionit me karakter ekonomik e shoqeror, botim gazetash, librash e revistash, broshurash, fletapaqlosjesh, posterash e materiale te tjera me karakter publicistik e jo publicistik, tipografi, import-eksport letre, paisje e materiale tipografike, si dhe botimin e Gazetes “Sot”, import-eksport mallrash industriale, ushqimore fruta e perime, pije alkoolike dhe jo alkoolike, materiale ndertimi, elektroshtepiake, karburante, vajra lubrifikante me pakice, dhe perpunimin te produkteve ushqimore.

#### NENI 4

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin, vendqendrimin dhe objektin e veprimtarise se saj sipas vendimeve qe do te marrin me miratim te perbashket ortakët.

#### NENI 5

Per realizimin e objektivave te shoqerise ortakët rane dakort te bashkojne kapitalet e tyre per persosjen e organizimit e zhvillimin e veprimtarise se saj. Kapitali themeltar I shoqerise do te jete **100.000 leke** te dhe perbehet nga kontributet si me poshte :

1. Z. ARJAN PRODANI \_\_\_\_\_ 35 %
2. Z. SHPETIM PRODANI \_\_\_\_\_ 26 %
3. Z. ARBEN MECE \_\_\_\_\_ 10 %
4. Z. SOKOL KOSOVA \_\_\_\_\_ 20 %
5. Z. MARTIN LEKA \_\_\_\_\_ 9 %

Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar jane nenshkruar e shlyer krejtesisht , pastaj jane ndare ndermjet ortakeve si me siper.

Cdo kuote i takon e drejta e nje vote.

#### NENI 6

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve qe do te marrin ortakët, por ne asnje rast njeri ortak nuk mund te detyroje ortakun tjetër te rrise kuoten e tij ne kapitalin e shoqerise.

Ne rast se kapitali I shoqerise per shkak te humbjeve te vertetuara ne dokumentat financiare, rezulton me i vogel se gjysma e kapitalit themeltar, ortakët vendosin brenda tre muajve nga miratimi i llogaritjeve te percaktojne kete humbje, mbi mundesine e prishjes se parakoheshme te shoqerise. Ne rast se prishja nuk shpallet shoqeria zvogelon kapitalin e saj ne nje vlere jo me te vogel se ajo e humbjeve qe kane mbetur, pa mbuluar fondet rezerve.

#### NENI 7

Ortaku qe ka ndermend te shese te treteve kuotat e kapitalit te tij, teresisht ose pjeserisht, duhet te njoftoje me pare ortakun tjetër te shoqerise. qe ka te drejten e parablerjes qofte dhe ne kushte te barabarta. Kjo e drejte duhet ushtruar brenda 30 diteve nga data e komunikimit.

#### NENI 8

**Organet drejtuese te shoqerise jane :**

- 1) ASAMBLEJA -
- 2) ADMINISTRATORI-

Procedura per emerimin ne funksione perkatese dhe shkarkimin e tyre rregullohen sipas statutit te shoqerise.

#### NENI 9

Asamblea drejtohet nga administratori i shoqerise. Adminiatrator i shoqerise eshte- **Z.ARJAN PRODANI.**

#### NENI 10

Vendimet e asamblese jane te vlefshme , ne se jane miratuar nga te kater ortaket e saj. Vendimet e asamblese mund te merren edhe nepermjet konsultimit me krim, ne se nje nga ortaket nuk ka kerkuar mbledhjen e asamblese.

#### NENI 11

Likujdimet dhe transaksionet financiare do te depozitohen ne bankat shqiptare dhe ne ato te huaja, ku shoqeria ka llogarite e saj rrjedhese.

Per kapitalin thelemtar te shoqerise eshte hapur libri I llogarive ku do te shenohet kontributi I secilit ortak. Po keshtu shoqeria ka dhe perdor dokumentacionin sipas kerkesave te ligjit per kontabilitetin e te gjitha kerkesave te tjera financiare te domosdoshme per veprimtarine normale te saj.

#### NENI 12

Fitimi neto I realizuar nga shoqeria do te ndahet ndermjet ortakeve ne perpjestim me kontributin e secilit ne kapitalin themeltar te shoqerise, mbasi te jene likjuar te gjitha detyrimet, dhe te jete hequr 5 % qe do te futet ne fondin e rezerves ligjore, deri ne permbushjen e 1/10 te kapitalit te shoqerise.

#### NENI 13

Shoqeria fillon veprimtarine e saj vetem pasi te kete marre autorizimin e organeve kompetente sipas legjislacionit ne fuqi.

#### NENI 14

Ortaket jane te detyruar te ruajne karakterin sekret te dokumentacionit , te eksperiences te shkemyer, te realizuar, brenda veprintarise te shoqerise.

#### NENI 15

Te gjitha mosmarreshjet qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim do te paraqiten per zgjidhje ne Gjykatën kompetente shqiptare ne perputhje me legjislacionin ne fuqi .

#### NENI 16

Ne rast zgjidhje te kontrates, Asambleja percakton menyren e likujdimit dhe emeron nje ose me shume likujdator sipas normave ligjore.

#### NENI 17

Kjo kontrate u perpilua ne prani te ortakeve duke shprehur ne te vullnetin e lire te tyre.



Kontrata u perpilua ne tre kopje me fuqi te barabarta secila, per te depozituar ne organet gjyqesore dhe tatimore si dhe nje kopje te ruhet ne dokumentacionin baze te shoqerise,

**ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE  
"SOT +" SHPK**

1)Z.ARJAN PRODANI

2)Z.SHPETIM PRODANI

3)Z.ARBEN MECE

4)Z.SOKOL KOSOVA

5)Z.MARTIN LEKA

REPUBLICA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
NR. REP. 4232

**VERTETIM**

Ne Tirane, sot me daten 16.10. 2002, para meje noterit publik N.MURATI notere e Dhomes se Notereve Tirane,me seli ne Rrugam "Zhan D'ark"u paraqit personalish Z.ARJAN PRODANI , I dtl. 1965 , banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar., me cilesine e Administratorit i cili nenshkroi aktin e themelimi per krijimin e shoqerise " SOT +" SHPK me vullnet te lire e te plote si per vehte edhe per ortakete tjere Z.SHPETIM PRODANI , i dtl. 1950,Z.ARBEN MECE, idtl 1961,Z.SOKOL KOSOVA, idtl 1957,Z.MARTIN LEKA, i dtl 1959 madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar per te nenshkruar akte te tilla, Me nenshkrimin e ketyre akteve une noteri e vertetoj sipas ligjit



NOTERE  
Nezi Murati



# STATUT I SHOQERISE "SOT +" SHPK

## KREU I DISPOZITA TE PERGJITHSHME

### NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar emertohet "SOT +" shpk  
Shoqeria eshte nje person juridik shqiptar. Shoqeria fiton te drejten e personit juridik nga data e regjistrimit ne gjykate.

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar me dispozitat e parashikuara ne dokumentat e krijimit te saj, kontraten e kete statut si dhe me ligjin nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" si dhe ne baze te ligjit 7667 date 28 .1.1993, "per regjistrin Tregtar"

### NENI 2

SHOQERIA "SOT +" shpk ka statusin e personit juridik dhe vulen e saj .

### NENI 3

SHOQERIA "SOT +" shpk ka seline ne Republiken e Shqiperise, ne Rr . "Pjeter Pogdani" Nr 9/1 TIRANE  
Ajo mund te cele filiale, dege , e perfaqesi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte saj.

### NENI 4

Pjesmarrja ne shoqeri nuk I pengon ortaket te kene pavaresi ligjore, organizative dhe te drejte pronesie jashte Shqiperise. Po keshtu Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet e ortakeve te saj jashte veprimtarise se shoqerise.

### NENI 5

Shoqeria "SOT +" shpk do te kete per objekt te veprimtarise se saj :  
**Ushtrimin e aktivitetit ne fushen e grumbullimit dhe botimit te informacionit me karakter ekonomik e shoqeror, botim gazetash, librash e revistash, broshurash, fletepaqlosjesh, posterash e materiale te tjera me karakter publicistik e jo publicistik, tipografi, import-eksport letre, paisje e materiale tipografike, si dhe botimin e Gaztes "Sot", import-eksport mallrash industriale, ushqimore fruta e perime, pije alkoolike dhe jo alkoolike, materiale ndertimi, elektroshtepiake, karburante, vajra lubrifikante me pakice, dhe perpunimin te produkteve ushqimore.**

## KREU II TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEVE

### NENI 6

Ortaket kane keto te drejta kryesore, te cilat ushtrohen nepermjet vendimeve te marra nga Asambleja e ortakeve:  
- Te marrin pjese ne administrimin e veprimtarive ekonomike tregtare te shoqerise ne perputhje me kontraten dhe statutin.

- Te marrin pjese ne rezultatet e veprimtarise se shoqerise ne cdo forme dhe sasi qofte sic parashikohet nga kontrata dhe statuti.
- Te kerkojne dhe tu jepen te gjitha informatat qe kane te bejne me gjendjen tregtare dhe veprimtarine e shoqerise si dhe te gjith dokumentat e perpunuara nga shoqeria si bilanci dhe llogaria ekonomike.
- Te bejne propozime dhe t'i paraqesin ato per shqyrtim ne organin administrativ.
- Te heqin dore nga shoqeria duke ua ofruar kuoten e tyre ortakeve te tjere te cilet kane ete drejten e pare te blerjes. Neqoftese brenda 60 diteve asnje nga ortaket nuk pranon blerjen e pjeses ai ka te drejte ta shese tek personat e trete.

#### NENI 7

Ortaket kane keto detyre kryesore :

- Te depozitojne kuoten e tyre dhe kuoten eventuale. suplementare, ne perputhje me kontraten dhe statutin.
- Te marrin pjese ne administrimin e shoqerise nepermjet organeve te krijuara nga ata vete.
- Ti japin shoqerise te dhena te domosdoshme per perpunimin e cdo objekti te vecante ne veprimtarine e saj.
- Te kryej detyrat per realizimin e objektivave dhe te funksioneve qe kane.

#### NENI 8

Secili ortak ka te drejte te heq dore nga shoqeria duke ia njoftuar me shkrim vendimin e tij organit administrativ 2 muaj perpara dhe duke ceduar te drejten e rrjedhjes sipas nenit 6.

Heqja dore nga shoqeria nuk e liron ortakun nga detyrimet financiare te marra me para ndaj shoqerise dhe nuk pezullon detyrimet ndaj ortakut.

#### KREU 3

### KUSHTET EKONOMIKE

#### NENI 9

Veprimtaruia e shoqerise realizohet ne baze te leverdise ekonomike dhe pasqyrohet ne bilancet e saj.

#### NENI 10

Per te bere te mundur zhvillimin e veprimtarise te shoqerise vihet nje kapital baze prej **100.000 leke** te reja qe perbejne burimin fillestar per krijimin e fondit themeltar dhe perbehet nga kontributet si me poshte :

- |                       |       |      |
|-----------------------|-------|------|
| 1. Z. ARJAN PRODANI   | _____ | 35 % |
| 2. Z. SHPETIM PRODANI | _____ | 26 % |
| 3. Z. ARBEN MECE      | _____ | 10 % |
| 4. Z. SOKOL KOSOVA    | _____ | 20 % |
| 5. Z. MARTIN LEKA     | _____ | 9 %  |

Ortaket marrin pjese ne krijimin e kapitalit themeltar te shoqerise me kuotat e tyre qe percaktohen edhe ne kontraten per krijimin e shoqerise.



#### NENI 11

Shoqeria do te kryeje veprimtarine e saj pa kufizim, ne cdo rast mbi 15 vjet. Kur shoqeria pushon veprimtarine e saj pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka pjesen e mbetur te kapitalit dhe te te ardhurave ua ndan ortakeve ne perpjestim me kuoten e vene prej secilit per krijimin e jkapitalit baze te shoqerise.

#### NENI 12

Shoqeria eshte pronare perdoruese dhe disponuese e pasurive te saja, ne emer te vet, ne perputhje me qellimin dhe obejktivin e veprimtarise se saj.

Shoqeria mund te blere dhe shfrytezoje, te drejttat materiale ose jo , perfshire te drejten per te ofruar pasurite e saj dhe per te marre kredi bankare.

#### NENI 13

Shoqeria krijon fondin rezerve dhe fonde te tjera te vecanta financiare ( per zhvillimin e saj dhe per nxitjen ekonomike te valutes etj) Perberja shuma e pergjithshme burimet per krijimin e fondit rezerv, perdorimi dhe rregullimi i cdo fondi te vecante caktohen nga Asambleja e Ortakeve .

Shoqeria I disponon plotesisht mjetet e saj financiare.

Detyrimet qe mund te lindin gjate veprimtarise se saj mbulohen nga fondi rezerve dhe nga fondet e tjera, ose nga shumat suplementare qe mund te derdhin ortaket kur detyrimet nuk mund te mbulohen nga fondet ekzituese,

#### NENI 14

E ardhura bruto e shoqerise pasi zbriten amortizimi i te gjitha pasurive te luajteshme dhe te paluajteshme sipas rasteve te caktuara kuotat qe kane te bejne me kredite per investime, pagat dhe shtesat mbi pagat, shpenzimet per lendet e para ndihmese , apo energjine, si dhe per shpenzimet e pergjithshme te shoqerise dhe per ato qellime te tjera tregtare dhe jo tregtare etj. per rezerve financiare caktohet 5% e fitimit ( zbritur humbjet eventuale te viteve te meparshme te pambuluara). Derisa ky fond te arrije sa 10 % e fondit themeltar, pjesa e ngelur u ndahet ortakeve te shoqerise ne mase te barabarte sic eshte dhe kuota e tyre ne formimin e kapitalit te shoqerise.

Asambleja mund te vendose ete shperndaje shumat e vena menjeane per rezerven qe ajo ka ne dispozicion duke treguar shprehimisht llojet e rezervat ku jane marre koto shuma. Asnje shperndarje nuk mund te behet nese kapitalet e veta jane ose do te beheshin pas kesaj shpendarjeje me te vogla se sa shuma e kapitalit qe nuk lejohet te shperndahet sipas ligjit apo statutit.

#### NENI 15

Bilancet vjetore duhet te paraqiten brenda dates 31 mars te vitit pas ardhes nga organi administrativ pasi ta kete shqyrtuar me par asambleja e ortakeve.

#### NENI 16

Veprimtaria financiare e shoqerise realizohet ne baze te planeve financiare qe bejne pjese ne planin e veprimtarise ekonomike tregtare.

Planet financiare parashikojne aktivin dhe pasivin e veprimtarise te shoqersise te shprehura ne lek.

Llogaria kontabel dhe ajo ekonomike mbahen ne lek . Rezultatet financiare te veprimtarise se shoqerise caktohen ne baze te bilancit vjetor.

Shkembimi i monedhes shqiptare ne monedhe te huaj behet ne perputhje me kursin e caktuar nga Banka e Shtetit Shqiptar .

## KREU IV

### ADMINISTRIMI

#### NENI 17

Organi vendimor i shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve. Ne te marrin pjese ortaket me te drejte vote sipas madhesis se shumave te vena pre krijimin e kapitalit baze te shoqerise. Asambleja e ortakeve vendos per bilancin vjetor per ndryshimet ne statut, per shtimin ose pakesimin e kapitalit themelor te shoqerise, kundrejt te t treteve, per emerimin e organit administrativ si dhe per pushimin apo rritjen e veprimtarise te shoqerise. Percaktojne gjithashtu drejtimet kryesore te veprimtarise te shoqerise me shumice votash.

#### NENI 18

Organi administrativ i shoqerise emerohet ose riemerohet ne funnksonet e tyre nga asambleja e ortakeve, sipas propozimit te ortakeve, qe perfaqeson shoqerine, kundrejt te treteve brenda caqeve te objektit te veprimtarise se shoqerise, pervec ceshetjeve qe duhen vendosur nga Asambleja e ortakeve.

Administrator eshte **Z. ARJAN PRODANI**.

#### NENI 19

Organin administrativ eshte kompetent per te marre vendime per :

- Te therrase Asamblene e ortakeve me shkrim 15 dite me pare.
- Te miratoje planet dhe llogarite ekonomike mujore dhe tremujore , pas perpunimeve te tyre ne kuadrin e objektit te shoqerise sipas nenit 5.
- Te bej propozimet e nevojshme ne asamblene e ortakeve per ndryshimin e kapitalit themeltar te shoqerise ne rast nevoje.
- Te propozoje dokumenta normative qe perkufizojne raportet ne gjirin e shoqerise duke perfshire edhe kuadrin e personelit per te vendosur asamblene e ortakeve.
- Te propozoje strukturen e aparatit te shoqerise per te vendosur Asambleja e ortakeve.
- Te percaktoje ndarjen e vendeve te punes se atyre qe do te merren ne pune.
- Ti paraqese asamblese se ortakeve propozimet per rregullimin , krijimin dhe destinimin e fondeve te vecanta, ndarjen e fitimeve si dhe percaktimin e rregullave lidhur me shlyerjen e borxheve.
- Te paraqese propozimin per pushimin e veprimtarise se shoqerise
- Te perzgjedhe anetaret e komisionit te likujdimit te cilet emerohen dhe revokohen nga asambleja e ortakeve.
- Te kryeje veprimtarite per likujdimin ellogarive qe u perkasin ortakeve doreheqes te shoqerise
- Te perfaqesojne shoqerine ne veprime gjyqesore .

#### NENI 20

Marredheniet e punes se shoqerise rregullohen nepermjet kontrates se punes.

Per ceshjte qe nuk rregullohen ne kontraten e punes, zbatohen dispozitat e legjislacionit te punes .

**KREU V**  
**MBYLLJA E SHOQERISE**  
**NENI 21**

Veprimtaria e shoqerise pushon sipas propozimit te bere nga organi administrativ kur veprimtaria rezulton negative ose kur te gjith ortaket heqin dore nga shoqeria si dhe ne te gjitha rastet e tjera qe parashikohen ne kontrate. Shoqeria shperndahet ne formen e riorganizimit ose likujdimit .

**NENI 22**

Kur shoqeria likujdohet :

- Asambleja e ortakeve emeron komisionin e likujdimit te cilit i paraqet bilancin e likujdimit.

Shoqeria I jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te bilancit te likujdimit.

- Pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerite me te drejte shfrytewimi i kthehen ortakut pronar dhe vleresimi i shfrytezimit te bere ( te gezuar) llogaritet ne shumen qe duhet kthyer ortakut pronar.

Mjete financiare te fituara si rezultat I veprimtarise se shoqerise e te filialeve te saj si dhe fondet e tyre financiare ndahen ndermjet ortakeve ne perpjestim me kuotat e vena, pasi te jene bere pagesat per kreditoret.

**NENI 23**

Kur pushon veprimtaria e nje filiali per efekte riorganizimi te tij afatet e pushimit caktohen nga asambleja e ortakeve.

Likujdimi I filialeve behet ne te njejten menyre sic procedohet per shoqerine.

Mjete financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se filialit te likujduar dhe fondet e tij financiare vihen ne dispozicion te shoqerise, pasi tu jene bere pagesat kreditoreve.

Pasi behet njoftimi i mbylljes ose likujdimit dhe kryhen formalitetet perkatese shoqeria rregjistrohet ne regjistrin tregtar.

**KREU VI**  
**DISPOZITAT E [PERGJITHSHME**  
**NENI 24**

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut i referohet plotesimeve qe do te behen nga asambleja e shoqerise si dhe ligjeve te vecanta te legjislacionit shqiptar .

Ndryshimet dhe plotesimet e ketij statuti behen ne te njejten menyre dhe procedura me te cilen nxirret vete statuti. Ndryshimet nuk prekin personalitetin juridik te shoqerise.

**NENI 25**

Te gjitha kundërshtimet eventuale ndërmjet ortakeve të shoqërisë : i nënshtrohen kompetencës të një kolegji të përbërë prej tre arbitrash nga të cilët secila palë cakton nga një arbitër ndërsa i treti caktohet nga dy të parët ose nga kryetari i Gjykatës së Rrethit. Arbitrat kërkojnë zgjidhjen në mirekuptim dhe vendimet e tyre do të pranohen nga palët në konflikt si shprehje e vullnetit të tyre. Vendimet merren në vendim dhe kohën e parashikuar nga Asambleja e ortakeve.

**NENI 26**

Vendimet e kolegjit të arbitrave nëse njëra nga palët nuk është dakort mund të behen konflikt gjyqësor në Gjykatën e rrethit.

**ORTAKET THEMELUES TË SHOQËRISË  
" SOT +" SHPK**

1)Z.ARJAN PRODANI

2)Z.SHPETIM PRODANI

3)Z.ARBEN MECE

4)Z.SOKOL KOSOVA

5)Z.MARTIN LEKA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISË TIRANË  
NR. REP. 4232

**VERTETIMI**

Në Tiranë, sot me datën 16.10.2002, para meje noterit publik N.MURATI notere e Dhomes së Notereve Tiranë, me seli në Rrugam "Zhan D'ark"u paraqit personalisht **Z.ARJAN PRODANI**, i dtl. 1965 ,me cilesinë e Administratorit, banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plote juridike dhe për të vepruar.,me pasaportë me nr 1995375 së dhe ortakët **Z.SHPETIM PRODANI**,i dtl 1950,**Z.ARBEN MECE**,i dtl 1961,**Z.SOKOL KOSOVA**,i dtl 1957,**Z.MARTIN LEKA**,i dtl 1959 të cilët nënshkruan Statutin për krijimin e shoqërisë "**SOT +**" SHPK me vullnet të lire e të plote. Me nënshkrimin e këtyre akteve une noteri e vertetoj sipas ligjit.



NOTERE

Nezi Murati


REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
NR. 135 REP.

VERTETIM

Une Noteri NEZIR MURATI , notere e Dhomes se notereve Tirane, me seli ne Rrrugen " Bajram Curi ", vertetoj se sot me daten 17/10/2002, ne Tirane ne zyren time te noterise pranova shumen 100.000 Leke si kapital themeltar te shoqerise " SOT +" Shpk, nga Z. ARJAN PRODANI , i dtl 1965, me banim ne Tirane, , madhore, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar., person e njohur nga noterja.

NOTERI

*Nezir Murat*





**Vendim  
Nr 1 datë 26.08.2003**

**I Asamblesë së ortakëve të shoqërisë “Sot + SHPK”**

Me kërkesën e ortakëve Shpëtim Prodani, Arben Meçe, Sokol Kosova dhe ortakut Arjan prodani te cilet zoterojen 91 % te kutave te shoqerise u mblodh asambleja e ortakëve të Shoqërisë “Sot + SHPK”, ku morën pjesë të gjithë ortakët dhe bënë këtë mbledhje me këtë rend dite:

- Miratimin e shitjes së kuotave nga ortakët Shpëtim Prodani, Arben Meçe, Sokol Kosova, tek ortakut Arjan Prodani.

- Pasqyrimi i këtyre ndryshimeve në regjistrin tregtar.

Ortakët ishin dakord për shitjen e kuotave të tyre tek ortakut Arjan Prodani dhe vendosën si më poshtë:

Vendosi

Miratimin e shitjes së kuotave nga ortakët Shpëtim Prodani, Arben Meçe, Sokol Kosova, tek ortakut Arjan Prodani.

Ortakët e kësaj shoqërie zotërojnë kuotat në këtë shoqëri në këtë mënyrë: Shpëtim Prodani 26%, Arben Meçe 10%, Sokol Kosova 20%, dhe Arjan Prodani 35%.

Ortakët e kësaj shoqërie kuotat e tyre ia shesin Arjan Prodanit në këtë mënyrë.

Shpëtim Prodani 26% të kuotave përkundrejt shumës prej 26 000 lekë.

Arben Meçe 10% të kuotave përkundrejt shumës prej 10 000 lekë.

Sokol Kosova 20% të kuotave përkundrejt shumës prej 20 000 lekë.

ne kete menyre ortakut Arjan Prodani behet zoterues i 91 % i kuotave te shoqerise “SOT+” SHPK

Shitblerja e kuotave bëhet me këtë akt noterial.

- Pasqyrimin e këtyre ndryshimeve në regjistrin tregtar

- Për kryerjen e këtyre ndryshimeve ngarkohet ortakut Arjan Prodani.

Vendimi i mësipërm u nënshkrua prej asamblesë së ortakëve.

**Asambleja e ortakëve të shoqërisë “Sot + “SHPK**

Shpëtim Prodani      Arben Meçe      Sokol Kosova      Arjan Prodani




REPUBLICA E SHQIPËRISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE  
NR 3280 REP  
NR 2 KOL

**VERTETIM**

Ne Tirane sot me daten 18 09.2003 (gusht dy mije e tre) para meje Noterit - Vangjel  
Dava u paraqiten personalisht :

Shpetim Prodani, i biri Muhametit dhe Sherihatit, dt 02.11.1950, banues ne Durres, madhore, me zotesi te plote juridike, me identitet te njohur me pasaporte Nr 14121696  
Arben Meçe, i biri i Laverit dhe Nazmies, dt 01.12.1961, dt 02.11.1950, banues ne Durres madhore, me zotesi te plote juridike, me identitet te njohur me pasaporte Nr.1321135.  
Sokol Kosova, i biri Bardhylit dhe Rukijes, dt 17.12.1957 banues ne Tirane, madhore, me zotesi te plote juridike, me identitet te njohur me pasaporte A.Z.052860  
Arjan Prodani, i biri i Muhametit dhe Manushaqes, dt 25.09.1965 banues ne Tirane, madhore, me zotesi te plote juridike, identiteti i te cilit m'u be i njohur me pasaporte nr. 0011472 te cilet nenshkruan kete akt para meje noterit dhe une noteri e legalizoje per te gjitha efektet e ligjes.

**NOTERI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE  
NR 3779 REP  
NR 200 KOL



### KONTRATE SHITBLERJE

Ne Tirane sot me daten 18 09.2003 (gusht dy mije e tre) para meje Noterit - *Vauqijël*  
Dato u paraqiten personalisht palet kontraktuese

**SHITESIT:** Shpetim Prodani, i biri Muhametit dhe Sherihatit, dt 02.11.1950, banues ne Durres, madhore, me zotesi te plote juridike, me identitet te njohur me pasaporte Nr 14121696

Arben Meçe, i biri i Laverit dhe Nazmies, dt 01.12.1961, dt 02.11.1950, banues ne Durres madhore, me zotesi te plote juridike, me identitet te njohur me pasaporte Nr.1321135.

Sokol Kosova, i biri Bardhylit dhe Rukijes, dt 17.12.1957 banues ne Tirane, madhore, me zotesi te plote juridike, me identitet te njohur me pasaporte A.Z.052860

**BLERESI:** Arjan Prodani, i biri i Muhametit dhe Manushaqes, dt 25.09.1965 banues ne Tirane, madhore, me zotesi te plote juridike, identiteti i te cilit m'u be i njohur me pasaporte nr. 0011472

Palet kontraktuese jane ortake te shoqerise "SOT+ SHPK" dhe zoterojne kuotat ne kete Shoqeri ne kete menyre :

Shpetim Prodani 26% , Araben Meçe 10% , Sokol Kosova 20% dhe blersi Arjan Prodani zoteron 35% te kuotave ne kete shoqeri .

Shitesit ja shesin kuotat e tyre bleresit i cili eshte dakort me blerjen e kuotave te bleresve dhe konkretisht

Shpetim Prodani i shtet 26 % te kuotave perkundrejt shumes prej 26000 , Arben Meçe 10% te kuotave perkundrejt shumes prej 10 000 leke dhe Sokol Kosova 20% te kuotave perkundrejt shumes prej 20 000 leke shume kjo te cilat jane shlyer teresisht prej bleresit para perpilimit te kesaj kontrate jashte kesaj zyre .

Ne kete menyre me kete shitblerje shitesit humbasin pronesine ne menyre te plote mbi kuotat qe zoteronin ne kete shoqeri dhe bleresi Arjan Prodani behet zoterues i 91 % (nentedhjte e nje) te kuotave te shoqerise "SOT+SHPK"

Persa me siper u perpilua kjo kontrate e cila pasi u gjet ne pajtim me ligjen dhe me vullnetin e tyre u kuptua prej tyre dhe u nenshkrua prej tyre dhe me pas prej meje Noterit per te gjitha efektet e ligjes


**SHITESIT**

**SHPETIM PRODANI**  
**ARBEN MEÇE**  
**SOKOL KOSOVA**


**BLERESI**

**ARJAN PRODANI**

**NOTERI**



*Arjan Prodani*  
*Vauqijël Dato*





## Proses-verbal

mbajtjen sot më datë 26.08.2003 për  
mbledhjen e Asamblesë së ortakëve të  
Shqipërisë "SOT" sh.p.k.

Rendi i ditës:

Shitja e kuotave të ortakëve Shqipëria  
Producenti 26%, Arben Mese 10%, dhe Sokol  
Kosova 7% ortakut Arjan Prodheri, si  
dhe miratimi i shifrës së kuotave me  
akt-noterice.

Në mbledhje morë pjesë të gjithë  
ortakët e Shqipërisë.

Ortaku Arben Mese shpjestoi në fa-  
shet kuotat e tij që ka në këtë  
shqetësi, Arjan Prodherit.

Ortaku Shpëtim Prodheri shpjestoi  
në fa shet kuotat e tij në masën  
prej 26% ortakut Arjan Prodheri.

Ortaku Sokol Kosova shpjestoi në  
fa shet kuotat e tij në masën 7%  
ortakut Arjan Prodheri.

Ortaku Martin Leka kuotat e tij  
në masën prej 9% të kuotave që ka  
në këtë shqetësi nuk i shet aktualisht.

vendimi i marrë më në  
votë dhe rezultoi:

28409/A

3 E Bazo  
19 \$ Baza PP 2003  
for 2003  
Halla

**KERKESE**

**KERKUES** : Arjan Prodani , i biri Muhametit dhe i Manushaqes , dtl 25.09.1965 , banues ne Tirane ,

**OBJEKTI** : Depozimit VENDIM NR 1 DATE 26.08.2003 I

Asamblese se ortakeve te Shoqerise " SOT +"SHPK

si dhe I kontrates se shitjes se kuotave

.Ligji 7638 date 19.11.1992 " Per Shoqerite tregetare " dhe ligji Nr 7667

date 28.1.1993 " Per rregjistrin tregetar "

**PERPARA GJYKATES SE RRETHIT TIRANE**

Ju parashtroje se me vendim nr 1 date 26.08.2003 I

Te Asamblese e ortakeve te Shoqerise " SOT +"SHPK

eshte vendosur

.Shitja e kuotave nga ortakët Shpetim Prodani, Arben Mice , Sokol Kosova

tek ortaku Arjan Prodani duke u bere zoterues i 91% e kuotave

Pasqyrimi i ketyre ndryshimeve ne rregjistrin tregetar .

Ne keto kushte keto ndryshime duhen te pasqyrohen ne rregjistrin tregetar

Bashkengjitur vendimin e Asamblese se ortakeve dhe kontrata e shitjes se kuotave .

Per gjithe sa me siper prej asaj gjykate :

**KERKOJE** : Pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne rregjistrin tregetar

Kerkesesi

Arjan Prodani

*(Handwritten signature of Arjan Prodani)*

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**

**DHOMA E NOTEREVE TIRANE**

Nr 3778 rep

Nr 2 kol

**VERTETIM**

Ne Tirane sot me daten 18 . 09 . 2003 ( Q dymije e tre ) para meje


Noterit Vendim Doko u paraqit Arjan Prodani , i biri Muhametit

dhe i Manushaqes , dtl 25.09.1965 , banues ne Tirane , madhore , me

zotesi te plote per te vepruar , i pajisur me pasaport Nr 1995375 , i cili u

nenshkrua prej tij dhe me pas prej meje noterit per te gjitha efektet e ligjes .

**NOTERI**



*(Handwritten signature of the notary)*

KERKESË

SA Copo  
15 10 2002  
*[Signature]*

**KERKUES:** ARJAN PRODANI ,i biri i Muhametit, I datelindjes 25.09.1965,  
lindur dhe banues ne Tirane,rr"Pjeter Pogdani",9/1, madhor, me zotesi te plote juridike  
dhe per te vepruar.,i njohur nga noteri.

28409

**ME OBJEKT :** Rregjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te  
kufizuar"SOT +" SH.P.K..

**BAZA LIGJORE:** Ligji nr 7638/dt.19.11.1992."Per shoqerite tregtare" dhe ligji nr  
7667,det.28.01.1993"Per rregjistrin tregtare"

5

**PERPARA  
GJYKATES SE RRETHIT  
TIRANE**

Zoti Kryetar!

Une kerkuesi Arjan Prodani kam themeluar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar  
"SOT+"shpk.Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100000(njeqind mije) Lek.  
Selia e shoqerise eshte ne Tirane Rr" Pjeter Pogdani" 9/1.

Kohezgjatja e shoqerise eshte 15 vjet.

Administrator i vetem i kesaj shoqerie jam une Arjan Prodani.

Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie eshte ushtrimitin e aktivitetit ne fushen  
grumbullimit dhe te botimit te informacionit me karakter ekonomik e shoqeror, botim  
gazetash, librash e revistash,broschurash, fletopisimesh, posterash e materiale te tjera me  
karakter publicistik e jo publicistik, ekon  
tipografi,import-eksport letre, paisje e materiale tipografike, si dhe botimin egazetes  
"SOT",import eksport mallrash industriale, ushqimore fruta perime,pije alkoolike dhe  
jo alkoolike,materiale ndertimi,elektroshteplate,karburante,vajra lubrifikante me  
pakice,dhe perpunim te produkteve ushqimore.

Kerkoj te merret ne shqyrtim kerkesa jime dhe ne perfundim te vendoset sipas objektit  
duke rregjistruar si person juridik shoqerine me pergjegjesi te kufizuar"SOT+"sh.p.k.

*[Large handwritten signature]*

**KERKUES  
ARJAN PRODANI**

*[Handwritten signature]*



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
NR/231/REP.  
NR. - KOL.

VERTETIMJ

Ne Tirane, sot me daten 16.10.2002. para meje notere N.MURATI , notere e  
Dhomes se Notereve Tirane,me seli ne Rrugam "Zhan D'ark"u paraqit Arjan Prodani , I  
d.l. 1965 , banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te  
vepruar.,me indetitetin e te cilit u garantova nga pasaporta e tij me cilesine e  
Administratorit dhe te ortakut se SH.K.P "SOT +" ,nenshkroi me vullnetin elire dhe te  
plote aktin e mesiperm dhe une noteri vertetoj nenshkrimin e tij.

NOTERE

*Arjan Murati*  
*[Signature]*